



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.10.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **WOOD CORPORATION L.L.C.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ritender - Furnizim me shtretër, dyshekë, jastykë, çarçafa dhe dollapa për qerdhe të reja**", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-9451-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-129 -121, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **WOOD CORPORATION L.L.C.**, e dt.03.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ritender - Furnizim me shtretër, dyshekë, jastykë, çarçafa dhe dollapa për qerdhe të reja**", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-9451-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-129 -121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 28.09.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **28.09.2023**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Ar sy e t i m

Me dt.03.10.2023, Operatori Ekonomik **WOOD CORPORATION L.L.C.**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “**Ritender - Furnizim me shtretër, dyshekë, jastykë, çarçafa dhe dollapa për qerdhe të reja**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-9451-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-129 -121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.10.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse sipas parallogarisë së Njësisë kërkesës, çmimet te pozicioni 4 dhe 5 në ofertën e Operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, nuk janë abnormalisht të ulëta.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës